



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:219382

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474613

CP.nr.1052/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm me gjyqtarin individual Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përmbarimore të kreditorëve J.G., L. H., H. M., I. S., F.V., N. S., L.Xh. D. M., V. S., S.V., te cilët me autorizim i përfaqëson avokat Leutrim Ademi me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, - Drejtoria e Arsimit, lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përmbarimor - Aktgjykimi Cnr. 530/2019, te datës 04.06.2021, të lejuar me aktvendimin për përmbarim CP.1052/2021, te datës 01.09.2021, jashtë seance gjyqësore, me datën 19.03.2024 morri këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbarimore e udhëhequr sipas shenjës CP.1052/2021, me kreditor J.G., L. H., H. M., I. S., F.V., N. S., L.Xh. D. M., V. S., S.V., ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, -Drejtoria e Arsimit,” për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditorët e përmbarimit J.G., L. H., H. M., I. S., F.V., N. S., L.Xh. D. M., V. S., S.V., përmes te autorizuarit te tyre avokat Leutrim Ademi me seli ne Mitrovice, kane paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit përmbarimor - Aktgjykimi Cnr 530/19, te datës 04.06.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbarimit, me aktvendimin CP.1052/2021, te datës 01.09.2021, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, -Drejtoria e Arsimit”.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP.1052/2021, te datës 01.09.2021, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt. ..., ka njoftuar gjykatën se debitori i përmbarimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

CP.nr.1052/2021 më datë 19.03.2024

Gjyqtari

Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditore nga dita e pranimin të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.